



37 /2024

Presidentja e Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 80 (3) dhe nenit 84 (6) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nxjerr:

## V E N D I M

Për kthimin për rishqyrtim të Ligjit Nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Republikës së Kosovës, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 31 tetor 2024, dhe të pranuar nga Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës më 11 nëntor 2024.

## A R S Y E T I M

Me datë 31 tetor 2024, Kuvendi i Republikës së Kosovës e ka miratuar në lexim të dytë Ligjin Nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Republikës së Kosovës, i cili rregullon funksionimin e Këshillit të Sigurisë dhe ndërveprimet me institucionet e tjera përkatëse në fushën e sigurisë kombëtare. Ky Ligj njëkohësisht parasheh shfuqizimin e Ligjit Nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, i cili deri më tani ka rregulluar funksionimin e Këshillit si në kohë paqeje, ashtu edhe në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme.

Sidoqoftë, në paragrafin e dytë të nenit 2 të Ligjit të ri të miratuar nga Kuvendi, është përcaktuar se: *“funksionimi i Këshillit në gjendje të jashtëzakonshme rregullohet me ligjin përkatës për gjendjen e jashtëzakonshme.”* Mbi këtë bazë, Ligji i miratuar nga Kuvendi ka fshirë të gjitha dispozitat e ligjit paraprak (Ligji Nr. 03/L-050), respektivisht Kreun II, me të cilin rregullohet mandati, funksionimi, kompetencat dhe përbërja e Këshillit në gjendje të jashtëzakonshme. Si rrjedhojë e kësaj dhe në mungesë të një ligji tjetër në fuqi i cili do të rregullonte këtë fushë, funksionimi i Këshillit të Sigurisë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme mbetet krejtësisht i pa rregulluar, duke rrezikuar kështu drejtpërdrejtë sigurinë kombëtare të shtetit tonë.

Prandaj, shpallja e Ligjit Nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Republikës së Kosovës do të krijonte zbrazëti ligjore në rregullimin e funksionimit të Këshillit të Sigurisë në gjendje të jashtëzakonshme, pikërisht në një situatë kur funksionimi i mirëfilltë e i bazuar në ligj është i rëndësishëm jetike. Kjo mangësi së pari rrezikon drejtpërdrejtë interesat legjitime të Republikës së Kosovës, dhe së dyti bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, respektivisht me nenet 125 (2), 127 (3), dhe 131 (8) të Kushtetutës.

Neni 84, paragrafi 6 i Kushtetutës përcakton se Presidentja e Republikës së Kosovës *“ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës”*. Siç sqarohet edhe në Komentarin e Kushtetutës, ky nen

nënkupton se Presidentja e Republikës gëzon jo thjeshtë të drejtën e kontrollit të procedurës së ndjekur por edhe substancës së vet ligjit, përmes së cilit Presidentja e ushtron të drejtën për kontroll kushtetues të ligjeve.

Andaj, në mbështetje të nenit 84, paragrafi 6 të Kushtetutës, kam vendosur ta kthej Ligjin Nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Republikës së Kosovës për rishqyrtim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

***Ligji bie në kundërshtim me nenin 125 (2) dhe nenin 127 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës***

Neni 125, paragrafi 2 i Kushtetutës i obligon institucionet e Kosovës që të mbrojnë sigurinë publike dhe të drejtat e të gjithëve në Republikën e Kosovës. Tutje, neni 127, paragrafi 3 i Kushtetutës e obligon Këshillin e Sigurisë që punën e tij ta bashkërendojë ngushtësisht me Presidentin. Ndërkaq, vetë Ligji Nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë, i miratuar nga Kuvendi, përcakton se “qëllimi i këtij Ligji është bashkërendimi dhe bashkëpunimi institucional në fushën e sigurisë kombëtare, përmes Këshillit të Sigurisë (...)”.

Obligimi i institucioneve të Republikës së Kosovës për mbrojtjen e sigurisë kombëtare, sigurisë publike, të drejtave e lirive të qytetarëve të Republikës së Kosovës si dhe bashkërendimi i punës së Këshillit me Presidenten është tejet i rëndësishëm, në veçanti në situata të gjendjes së jashtëzakonshme.

Në këtë drejtim, mospërfshirja e dispozitave që rregullojnë funksionimin e Këshillit gjatë gjendjes së jashtëzakonshme krijon një vakuum juridik i cili ua pamundëson institucioneve të Republikës së Kosovës që janë pjesë e Këshillit mbrojtjen e sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe të drejtave të qytetarëve të saj në situatat kur shpallet gjendje e jashtëzakonshme. Në të njëjtën kohë, ky vakuum e pamundëson edhe vetë qëllimin e përcaktuar me Ligjin e miratuar, sepse e pengon “bashkërendimin dhe bashkëpunimin institucional në fushën e sigurisë kombëtare” pikërisht në momentet kur ai është tejet esencial.

Pavarësisht faktit se Ligji që synohet të shfuqizohet përmban dispozita të pakta dhe jo të mjaftueshme sa i përket mënyrës së funksionimit të Këshillit gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, kthimi në një situatë ku nuk ka fare rregullim juridik është shumë më i dëmshëm, sepse pamundëson funksionimin kushtetues të institucioneve përkatëse në raste të tilla.

Në ndërlidhje me këtë, Kushtetuta e ka mandatuar Presidenten e Republikës së Kosovës me kompetencën ekskluzive “për të garantuar funksionimin kushtetues të institucioneve të Republikës së Kosovës”, ndaj kthimi i këtij Ligji për rishqyrtim në Kuvend është në përputhje të plotë me ushtrimin e kësaj kompetence.

### *Ligji bie në kundërshtim me nenin 131 (8) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*

Neni 131 i Kushtetutës ofron një kornizë të përgjithshme të funksionimit të institucioneve shtetërore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Duke u bazuar në paragrafin 1 të këtij neni, shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme nga Presidenti i Republikës së Kosovës ndërlidhet me situata kritike të cilat, *ndër të tjera*, vënë në rrezik sigurinë kombëtare dhe rendin kushtetues të Republikës së Kosovës.

Tutje, paragrafi 8 i këtij neni të Kushtetutës në mënyrë shprehimore përcakton se “*gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, Këshilli i Sigurisë i Republikës së Kosovës do të drejtohet nga Presidenti i Republikës së Kosovës, sikur rregullohet me ligj.*”

Pra, rregullimi *me ligj* i funksionimit të Këshillit gjatë gjendjes së jashtëzakonshme është kërkesë që derivon nga vetë Kushtetuta.

Si materializim i kësaj kërkesë kushtetuese, Ligji i miratuar në vitin 2008, i cili synohet të shfuqizohet nga Ligji i ri, ka vendosur bazat kryesore të funksionimit të Këshillit në gjendje të jashtëzakonshme. Rrjedhimisht, përderisa përmes miratimit të një ligji të ri, ka pasur mundësi që kjo çështje të rregullohet edhe më në detaje, konsideroj se asesi nuk është dashur të bëhet e kundërta, pra fshirja edhe e atyre pak neneve që përmban Ligji i miratuar në vitin 2008. Kjo për faktin se e gjithë esenca e themelimit të Këshillit është pikërisht roli i tij në situatat kur Republika e Kosovës përballlet me rreziqe (qofshin ato të brendshme apo të jashtme), aq më tepër kur niveli i rrezikshmërisë është i tillë sa duhet shpallur gjendja e jashtëzakonshme.

Në këtë frymë, vlen të theksohet se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në Aktgjykimin në rastin KO43/19, ka obliguar Kuvendin e Republikës së Kosovës që gjatë nxjerrjes së ligjeve, të ketë parasysh frymën e Kushtetutës dhe fushëveprimin e institucioneve kushtetuese.

Duke pasur parasysh këto argumente, mospërfshirja e dispozitave të lartcekura në Ligjin e ri për Këshillin e Sigurisë, pamundëson zbatimin e nenit 131 të Kushtetutës dhe rrjedhimisht, bie ndesh me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Për më tepër, rregullimi i funksionimit të një institucioni me dy ligje të ndryshme, njëri gjatë kohës së paqes ndërsa tjetri për gjendje të jashtëzakonshme, nuk është në përputhje me një praktikë tashmë të konsoliduar të hartimit të akteve juridike në Republikën e Kosovës. Ndjekja e praktikës së Ligjit të ri për Këshillin e Sigurisë do të nënkuptonte që Kosova do të duhej ta kishte një ligj për funksionimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës në kohë paqeje, dhe një tjetër për rregullimin e funksionimit të saj në kohë lufte. Megjithatë, ky nuk është rasti, sepse në fuqi kemi vetëm një ligj për FSK-në, ashtu siç kemi vetëm një ligj për Presidentin, për Qeverinë, Policinë e kështu me radhë.

### *Pasojat e zbrazëtirave ligjore në Ligjin Nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë*

Të gjitha argumentet ligjore të prezantuara më lartë duhet parë në dritë të kontekstit të Republikës së Kosovës. Në shtator të vitit 2023 Serbia ka kryer akt agresioni kundër Republikës së Kosovës. Ky akt agresioni është tregues i qartë se Serbia dhe struktura aktuale politike e saj nuk është e interesuar për paqe as për fqinjësi të mirë, gjë që përbën kërcënim të vazhdueshëm ndaj sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Ky akt agresioni ishte plan i qartë për aneksimin e veriut të Kosovës dhe destabilizim jo vetëm të vendit tonë, por edhe gjithë rajonit, duke vërtetuar se ambiciet hegjemoniste të Serbisë nuk kanë marrë fund. Në rrethana të përballjes së vazhdueshme me këto tendenca destabilizuese dhe në përpjekje të vazhdueshme për ruajtje të paqes, sigurisë, stabilitetit, si dhe të sovranitetit e integritetit territorial në bashkëpunim me aleatët tanë, Kosova duhet ta ketë të gatshme bazën ligjore për funksionimin e institucioneve të saj në çdo situatë.

Përveç situatave të rreziqeve që vijnë nga jashtë, jemi edhe dëshmitarë të një numri të madh të fatkeqësive natyrore që së fundi kanë goditur shtetet e rajonit e më gjerë, siç janë zjarret, vërshimet, tërmetet etj., e të cilat në të kaluarën kishin ndodhur edhe në Kosovë. Këto fatkeqësi kanë pasur pasoja katastrofike, përfshirë humbje të mëdha të jetëve, madje edhe të shtetave të cilat kanë infrastrukturë tejet të zhvilluar për menaxhimin e këtyre situatave. Zjarret e vërshimet kanë qenë situata të vazhdueshme me të cilat është përballur edhe Kosova, ndërkaq për shkak të ndryshimeve klimatike pritet që bota do të përballlet edhe më shumë me pasoja të tilla. Pikërisht për shkak të paparashikueshmërisë së këtyre ngjarjeve, është obligim i yni kushtetues që në çdo moment të kemi kuadrin e nevojshëm ligjor për funksionimin e institucioneve në kohë të gjendjes së jashtëzakonshme.

Në dritë të këtyre rrethanave, shpallja e Ligjit Nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë thekson edhe më tepër shqetësimet legjitime lidhur me menaxhimin e krizave dhe rreziqeve me të cilat mund të përballlet Kosova. Prandaj, rregullimi, qoftë edhe bazik i funksionimit të Këshillit të Sigurisë në gjendje të jashtëzakonshme, është thelbësisht i nevojshëm nëse e krahasojmë me një situatë ku nuk ka rregullim fare.

Aspekt tjetër i cili duhet pasur parasysh është fakti se gjendja e jashtëzakonshme implikon edhe nevojën e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut [neni 56 dhe neni 131 (2) i Kushtetutës]. Kështu, Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin e saj në rastin nr. KO54/20, sqaron rëndësinë e rregullimit *me ligj* të të gjitha rrethanave që mund të kenë ndërlidhje apo implikime në kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Për më tepër, Aktgjykimi në fjalë vë në pah standardet që duhet të ndjekë Kuvendi, në mënyrë që çfarëdo kufizimi i lirive dhe të drejtave të njeriut të jetë i rregulluar me ligj. Në këtë frymë, miratimi i një ligji të ri i cili krijon zbrazëti ligjore pikërisht në një fushë e cila ndërlidhet ekskluzivisht me kufizimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, bie ndesh me standardet dhe praktikën e ndërtuar nga Gjykata Kushtetuese. Për më tepër, mungesa e një baze ligjore krijon rrethana të pasigurta të cilat imponojnë nevojën që institucionet përgjegjëse të

nxjerrin vendime dhe akte të tjera nënligjore pa bazë specifike ligjore. Edhe vetë Gjykata Kushtetuese në Aktgjykimin e saj në rastin nr. KO54/20K ka vlerësuar se kjo praktikë është kundërkushtetuese.

Andaj, duke u bazuar në argumentet e mësipërme, konsideroj se gjatë nxjerrjes së Ligjit Nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka qenë i obliguar të ndjekë frymën e Kushtetutës dhe interesin legjitim të vendit në raport me rregullimin e funksionimit të Këshillit të Sigurisë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Si përfundim, mbështetur në arsyetimin e këtij Vendimi, i kthej për rishqyrtim Kuvendit të Republikës së Kosovës Ligjin Nr. 08/L-287 për Këshillin e Sigurisë së Republikës së Kosovës, me qëllim të përfshirjes së kapitullit përkatës i cili rregullon funksionimin e Këshillit të Sigurisë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

Me respekt,

Vjosa Osmani- Sadriu



Presidente e Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 18. 11. 2024

***Vendimi i dërgohet:***

1. Kuvendit të Republikës së Kosovës;
2. a/a.